



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:245386

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05640883

KA.nr.983/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arben Toska, në konfliktin administrativ të paditësit “Laboratori Biokimik dhe Ambulancë Specialistike e Sëmundjeve të Brendshme Hipokrati” (N.O. BI) me NUI 810354712 dhe seli në rrugën Lekë Dukagjini p.nr. në Mitrovicë, kundër të paditurit Qeveria e Kosovës, Ministria e Shëndetësisë, Inspektorati i Shëndetësor me seli në Prishtinë, objekti i kontesti anulimi i aktit administrativ, pas seancës publike të shqyrtimit kryesor të datës 17.04.2024 në të cilën mori pjesë paditësi dhe i padituri, më 30 prill 2024 dha këtë:

A K T G J Y K I M

- I. Hedhet poshtë padia e paditësit “Laboratori Biokimik dhe Ambulancë Specialistike e Sëmundjeve të Brendshme Hipokrati” (N.O. BI) me NUI 810354712 kundër të paditurit Qeveria e Kosovës, Ministria e Shëndetësisë, Inspektorati i Shëndetësor me seli në Prishtinë, në pjesën me të cilën ka kërkuar anulimin vendimit nr. 10/Aj-060-21 të datës 28.07.2021 të Inspektoratit Shëndetësor.
- II. Aprovohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit “Laboratori Biokimik dhe Ambulancë Specialistike e Sëmundjeve të Brendshme Hipokrati” (N.O. BI) me NUI 810354712 kundër të paditurit Qeveria e Kosovës, Ministria e Shëndetësisë, Inspektorati i Shëndetësor me seli në Prishtinë, anulohet akti administrativ nr.10/K-36/21 i datës 22.09.2021 i Kryeinspektorit Shëndetësor, çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të paditura Ministria e Shëndetësisë, Kryeinspektori Shëndetësor, ashtu që në afat prej tridhjetë (30) ditëve në ri procedurë të nxjerrë akt të ri administrativ për ankesën e paditësit sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim.

III. Mbetet në fuqi aktvendimi A.nr. 2600/2021 i datës 03.11.2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, deri në vendim tjetër të gjykatës.

## A R S Y E T I M

### I. Padia, kërkesëpafia dhe pretendimet e palëve

1. Padiësi përmes padisë së datës 02.11.2021 e ka iniciuar konfliktin administrativ me kërkesë për anulimin e vendimit nr. 10/Aj -060-21 të Inspektoratit Shëndetësor dhe vendimi nr.10/K-36-21 të datës 22.09.2021 të Kryeinspektorit Shëndetësor.
2. Padiësi në padi por edhe gjatë seancës së shqyrtimit kryesor ka pretenduar se ankesaën e ka dorëzuar brenda afatit ligjor, por posta e ka kthyer se personi në atë adresë ka qenë i panjohur. Sipas tij, vendimi nr.10/K-36-21 i datës të datës 22.09.2021 nuk cek fare datën se kur i është dorëzuar vendimi, e as datën e dorëzimit të ankesës, si dhe nuk dihet në cilën ditë ka kaluar afati për paraqitjen e ankesës.
3. I Padituri me përgjigjen në padi, por edhe gjatë seancës së shqyrtimit kryesor e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e Padiësit duke theksuar se me asnjë provë nuk janë provuar deklaratimet e Padiësit, duke shtuar se ankesa e Padiësit ka qenë e pa afatshme. Ka theksuar se gjatë inspektimit është konstatuar se Padiësi ka vepruar në një lokacion tjetër nga ai për të cilën është licencuar, rrjedhimisht është gjobitur në lartësi prej 2000€.

### II. Provat e administruara dhe gjendja faktike e konstatuar

4. Me qëllim të konstatimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata i aprovoi të gjitha propozimet e palëve për administrimin e provave. Në këtë drejtim, në seancën për shqyrtimin kryesor u administruan provat si në vijim: vendimi me numër 10/AJ-060-21 i datës 28.07.2021 i Inspektoratit Shëndetësor; vendimi numër 10/K-36/21 i datës 22.09.2021 i kryeinspektorit shëndetësor; licenca me nr. 238/2019 e lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë në emër të N.O.; licenca e punës me nr. KO-7637-05-8.2 e lëshuar nga Oda e Infermierëve, mamive dhe profesionistëve të tjerë shëndetësor të Kosovës, si dhe të gjitha shkresat e lëndës të Procedurës Administrative të dorëzuara nga i padituri me përgjigjen në padi.
5. Në bazë këtyre provave gjykata konstaton se Inspektorati i Shëndetësor më 27.07.2021 e kishte inspektuar lokalitetin e të Padiësit në rrugën UÇK në Mitrovicë dhe mes tjerash

kishte konstatuar që Paditësi nuk ka licencë të vlefshme për lokalin në këtë lokacion, por vetëm për lokalin në rrugën Lekë Dukagjini p.nr. në Mitrovicë.

6. Më 04.06.2020 Inspektorati Shëndetësor e kishte nxjerrë vendimin nr. 10/Aj-060-21 me të cilin e kishte gjobitur Paditësin me 2000€ Paditësin për shkak të mungesës së licencës valide për të punuar në lokacionin e tij në rrugën UÇK në Mitrovicë. Në vendim ishte dhënë këshilla juridike se mund të ushtrohet ankesë në afatin prej 8 ditëve.
7. Më 23.08.2021 ishte protokolluar me numër 05-261/2 ankesa e Paditësi ndaj aktit administrativ të cekur në pasuesin e mësipërm. Kjo ankesë e mbante datën e përpilimit 19.08.2021.
8. Kryeinspektori Shëndetësor përmes vendimit nr. 10/K-36-21 të datës 22.09.2021 e kishte refuzuar si të pa afatshme ankesën e Paditësit dhe e kishte vërtetuar aktin administrativ të ankimuar. As në arsyetim të këtij vendimi nuk janë cekur të dhënat qenësore lidhur me afatshmërinë, gjegjësisht nuk është cekur se kur e ka pranuar Paditësit vendimin e shkallës së parë, kur e ka dorëzuar Paditësit ankesën e tij, ankesa a është dorëzuar direkt në zyrën e Kryeinspektorit Shëndetësor apo përmes postës.
9. Në shkresat e lëndës nuk gjendet asnjë provë nga e cila do të rridhte se kur Paditësit e ka pranuar vendimin e shkallës së parë, si dhe në çfarë mënyre e ka dorëzuar ankesën e tij.
10. Gjykata i mori parasysht edhe provat tjera të administruara, mirëpo nga ato nuk provohet as një fakt relevant që ka të bëjë me afatshmërinë e ankesës së Paditësit.

### III. Vlerësimi meritore i rastit

11. Gjykata në rend të parë e vlerësoi padinë e Paditësit me të cilën është goditur vendimi nr. 10/Aj-060-21 i datës 28.07.2021 i Inspektoratit Shëndetësor dhe gjeti se ajo është e palejueshme.
12. Neni 13 i LKA-së e ka rregulluar se cili akt administrativ i procedurës administrative mund të goditet me padi. Kështu, në para. 1 të nenit 13 të LKA-së parashihet se *“Konflikti administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë”*, ndërsa para. 2 i po të njëjtit nen ka përcaktuar se *“Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative ankimi nuk është i*

*lejuar*”. Sipas këtyre dispozitave juridike, vetëm akti administrativ përfundimtar i nxjerr në shkallën e dytë të procedurës administrative mund të jetë objekt për shqyrtimin e ligjshmërisë në procedurën e konfliktit administrativ, ndërsa akti administrativ i shkallës së parë përjashtimisht mund të jetë objekt i shqyrtimit të ligjshmërisë në procedurën e konfliktit administrativ vetëm nëse ndaj tij nuk lejohet ankesa.

13. Në rastin konkret, goditur vendimi nr. 10/Aj-060-21 i datës 28.07.2021 i Inspektoratit Shëndetësor është akt administrativ i shkallës së parë dhe ndaj tij ka qenë e lejuar ankesa, e madje është ushtruar ankesë në procedurë administrative. Kjo situatë është e rregulluar me nenin 34 para. 1 nënpara. 1.4 të LKA-së, sipas të cilit *“Gjykata e hedh poshtë padinë me vendim, nëse konstaton se: (...) 1.4. kundër aktit administrativ, i cili kontestohet me anë të padisë, mund të bëhet ankimi, kurse ankimi nuk është bërë fare apo nuk është bërë në kohën e duhur;”*.
14. Prandaj, për këtë gjykatë padia e Paditësit me të cilin e ka goditur aktin administrativ të shkallës së parë është e palejueshme, rrjedhimisht në bazë të nenit 34 para. 1 dhe 2 të LKA-së, në lidhje me nenin 13 para. 1 dhe 2 të LKA-së e hodhi poshtë padinë, si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi.
15. Në lidhje me kërkesëpadinë e Paditësit për anulimin e vendimit administrativ nr.10/K-36/21 të datës 22.09.2021 të Kryeinspektorit Shëndetësor, gjykata pas shqyrtimit të të gjitha pretendimeve të ndërgjyqësve, provave të administruara dhe të analizuara në kuptim të nenit 8 të LPK-së, si dhe analizimit të dispozitave juridike relevante gjeti se kërkesëpadia e është e bazuar.
16. Gjykata rikujton se Kryeinspektori Shëndetësor përmes vendimit nr.10/K-36/21 të datës 22.09.2021 e kishte refuzuar të pa afatshme ankesën e Paditësit dhe e kishte vërtetuar vendimin e Inspektoratit Shëndetësor. Siç është cekur edhe më lartë, Kryeinspektori Shëndetësor nuk i kishte dhënë arsyet qenësore lidhur me afatshmërinë e ankesës së Paditësit, por vetëm kishte konstatuar se Paditësi nuk e kishte respektuar afatin 8 ditor për paraqitjen e ankesës.
17. Për gjykatën, ky arsyetim është i mangët dhe në bazë të tij është e pamundshme që të kuptohen arsyet se pse është vendosur si në dispozitiv të atij vendimi. Sipas nenit 48 para. 1 të LPPA-së *“Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2.*

*shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim”, ndërsa sipas para. 2 të po të njëjtit nen “Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij”.*

18. Siç vërehet, LPPA-ja me qëllim që pala ta kuptoj aktin administrativ ka vendosur standarde strikte lidhur me arsyetimin e akteve administrative, të cilat zbatohen edhe në procedurën sipas ankesën në organin administrativ të shkallës së dytë. Sipas dispozitave të cekur më lartë, në arsyetim duhet të tregohet baza ligjore e vendimit dhe arsyet e zbatimit të asaj baze ligjore.
19. Për këtë gjykatë, nga arsyetimi i vendimit nr.10/K-36/21 të datës 22.09.2021 të Kryeinspektorit Shëndetësor nuk mund të kuptohet se pse është ankesa e Paditësit ka qenë e pa afatshme, meqenëse mungon data se kur Paditësit e kishte pranuar vendimin e shkallës së parë, kur Paditësit e ka parashtruar ankesën e tij, dhe atë ankesë a e ka parashtruar përmes postës apo direkt në zyrat e Inspektoratit Shëndetësor. Pa caktimin e datës së pranimit të vendimit të shkallës së parë, nuk mund të dihet nga cila datë ka filluar të ecë afati për paraqitjen e ankesës, ndërsa pa saktësimin e mënyrë së paraqitjes së ankesës, nuk mund të dihet se data e protollit e shënuar në ankesë a paraqet datë të arritjes së ankesës përmes postës te i Padituri, apo është datë dorëzimit të ankesës direkt në zyrën e të Paditurit. Të gjitha këto rrethana janë të rëndësishme për caktimin e afatshmërisë së ankesës.
20. Siç është cekur më lartë, akti administrativ i shkallës së dytë asnjërin nga këto kërkesat ligjore nuk i ka plotësuar, rrjedhimisht është i barabartë me një akt administrativ që nuk ka fare arsyetim. Si i tillë, është i paligjshëm në kuptim të nenit 48 para. 2 lidhur me nenin 52 para. 1 nënpara. 1.4 të LPPA-së, sipas të cilit “Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: (...) 1.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ”.
21. Gjykata rikujton se, ligjshmëria e aktit administrativ të kontestuar shqyrtohet nga gjykata brenda kufijve të kërkesës nga padia, por nuk obligohet nga shkaqet e padisë, siç parashih neni 44 para. 1 i LKA-së, ndërsa për nulitetin (paligjshmërinë) e aktit

administrativ gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare, siç urdhëron neni 44 para. 2 i LKA. Kjo nënkupton se, gjykata e shqyrton ligjshmërinë e aktit administrativ të goditur edhe për arsye të cilat paditësi nuk i nga ngritur para gjykatës.

22. Gjykata e sheh të rëndësishme të sqaroj se për shkak të metave të cekura më lartë e pati juridikisht të pamundshme që t'i vlerësoj pretendimet e Paditësit për gjendjen faktike, rrjedhimisht e pati të pamundur të vendos me juridiksion të plotë në kuptim të nenin 43 para. 3 të LKA-së.
23. Për këto arsye, gjykata e anuloi vendimin nr.10/K-36/21 të datës 22.09.2021 të Kryeinspektorit Shëndetësor dhe meqenëse karakterit i çështjes konkrete është i tillë që duhet që në vend të aktit të anuluar administrativ të nxirret një tjetër, atëherë gjykata e obligoi të Paditurin si organ administrativ i shkallës së dytë që jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga data e dërgimit të këtij aktgjykimit ta nxjerr aktin e ri administrativ dhe t'ia dërgoj Paditësit si palë ankuese.
24. Gjykata vendosi ta lë në fuqi aktvendimin A.nr. 2600/2021 të datës 03.11.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, me të cilin është shtyrë ekzekutimi i vendimit nr. 10/Aj -060-21 i datës 28.07.2021 Inspektoratit Shëndetësor dhe vendimi nr.10/K-36-21 i datës 22.09.2021 i Kryeinspektorit Shëndetësor, deri në vendim tjetër të gjykatës, meqenëse ende nuk është qartësuar afatshmëria e ankesës së Paditësit.

#### IV. Udhëzimet për organin administrativ në ri procedurë.

25. Në ri procedurë Kryeinspektori Shëndetësor si organ administrativ i shkallës së dytë duhet ta rivlerësoj ankesën e Paditësit dhe të nxjerrë akt administrativ të ri në përputhje me dispozitat LPPA-së. Ai me rastin e rivlerësimit të ankesës së Paditësit sidomos duhet ta shqyrtoj së pari ligjshmërinë e ankesës dhe nëse gjen se ankesa është e pa afatshme, atëherë në vendimin e ri duhet të jep të dhëna se kur e ka pranuar Paditësi ankesën, kur e ka dorëzuar ankesën dhe në çfarë forme e ka dorëzuar ankesën. Ndërsa nëse vlerëson se ankesa është e afatshme, atëherë duhet të vendos meritorisht për ankesën e Paditësit.
26. Gjykata rikujton se Kryeinspektori Shëndetësor me rastin e nxjerrjes së aktit të ri administrativ është i obliguar nga pikëpamja juridike e gjykatës, si dhe nga vërejtjet e gjykatës lidhur me procedurën, siç e ka paraparë neni 65 i LKA-së.

27. Për arsyet e cekura më lartë, duke u bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 43 të LKA-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Komerciale e Kosovës  
Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative  
KA.nr.983/2022

Gjyqtari

---

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Kundër këtij aktgjykimit mund të paraqitet ankesë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa në formë të shkruar dhe në ekzemplarë të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale.